



## KUVENDI I KOMUNËS KOMITETI PËR POLITIKË DHE FINANCA

### EKSTRAKT

nga procesverbali i mbajtur më 24 maj 2016, në mbledhjen e XXVIII-të  
(nëzëtetetë) e jashtëzakonshme të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Mbledhja u mbajt në sallën nr. 31 dhe filloi në orën 15.00'.

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi z. Mehmet Gashi, kryesues i Kuvendit, përkatësisht kryesues i këtij Komiteti.

Fillimisht u vërtetua se në mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e këtij Komiteti: Bahri Blakçori, Islam Revuçi, Fidan Rekalio, Haki Rudari, Kadri Avdiu, Kumrie Hoti, Mynavere Abdullahu – Krasniqi, Naim Çunaku dhe Rafet Llapashtica.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë dhe vendimmarrje.

Në mbledhje ishin të pranishëm edhe Faik Muçiqi, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit, Isuf Latifi, drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, Durim Salihu, drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit dhe Muharrem Haziri, OSBE.

### Rendi i ditës

#### - Rishikimi i buxhetit të Komunës për vitin 2016

**Kryesuesi z. Mehmet Gashi**, theksoi, kjo mbledhje është thirrë e jashtëzakonshme ngase Ministria e Financave ka kërkuar që rishikimi i buxhetit për vitin 2016 të bëhet më së largu deri më 25 maj 2016.

**z. Kadri Avdiu**, theksoi, unë kam vërejtje rreth dërgimit të materialit ngase materialin në formë fizike e kam marrë sot në orën 8.00

**Kryesuesi z. Mehmet Gashi**, theksoi, këshilltarëve materiali për mbledhje ju dërgohet në mënyrë elektronike.

**z. Kadri Avdiu**, theksoi, në mënyrë elektronike unë kam pengesa dhe jemi marrë vesh që materiali të më dërgohet në formë fizike.

**z. Haki Rudari**, theksoi, edhe unë jam konsultuar me kolegën Adelina Stublla dhe ajo më ka thënë se asaj nuk i është dërguar materiali, kuptohet në formë elektronike.

**Kryesuesi z. Mehmet Gashi**, theksoi, për dërgimin e materialit jemi shumë të kujdesshëm dhe është hera e parë që ka vërejtje, ndoshta ka të bëjë me ndonjë gabim teknik, mirëpo sido qoftë do të shikohet se çfarë është në pyetje, ndërsa z. Kadri Avdiu duhet të konsultohet me zyrën e Teknologjisë informative që në të ardhmen të mos ketë probleme për dërgimin e materialit.

**z. Isuf Latifi**, drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, e paraqiti fjalën hyrëse.

**z. Durim Salihu**, drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit, sqaroi arsyet për rishikimin e buxhetit për projektet në kompetencë të Drejtorisë përkatëse.

**z. Faik Muçiqi**, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit paraqiti arsyet e nevojës për rishikimin e buxhetit në kuadër të kësaj Drejtorie.

**z. Fidan Rekaliu**, theksoi, Grupi i këshilltarëve i LDK – së e përkrah propozimin për rishikimin e buxhetit për vitin 2016 dhe shtoi, unë nuk dëshiroj të lëshohem në detaje ngase drejtorët e Drejtorive përkatëse i paraqitën arsyet për ridestinime të nevojshme.

Mua më vjen mirë se me këtë rishikim po bëhet kompletimi i disa projekteve të cilat në njëfarë mënyre kanë qenë të pakompletuara për shkak të mjeteve financiare të pamjaftueshme.

Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit, ndihmë mjaftë të madhe i ka dhënë Ministria e Infrastrukturës e cila komunës së Podujevës për zhvillimin e infrastrukturës në gjithë territorin e komunës, i ka dhënë rreth 2 milion 300 mijë euro.

**z. Rafet Llapashtica**, theksoi, pajtohem se është e nevojshme të bëhet rishikimi i buxhetit, por duhet të kemi kujdes ridestini i mjeteve a bëhet në projektet në të cilat qytetarët kanë përfitime më të mëdha.

Në kodin e ri për rrugën për asfaltimin e rrugës Orllan – Ballaban janë paraparë 10.000 €, lidhur me këtë nuk e kam të qartë se a është rruga kryesore e cila lidhet me fshatin Keqekollë ngase sa jemi në dijeni për këtë rrugë Ministria e Infrastrukturës i ka zotuar mjetet përkatëse për realizimin e këtij projekti.

Për fshatin Bradash është hapë një kod i ri në shumë 110.000 €, kjo shumë e mjeteve është sa shuma e 7 apo 8 projekteve në mjedise të tjera, andaj duhet shikuar se sa kokë banori dëmtohen me heqjen e mjeteve nga afro 10 projekte dhe sa përfitojnë me hapjen e këtij kodi të ri për një projekt.

Ta lagjja Bajgora në fshatin Dobratin, rruga është shtruar por nuk jam në dijeni se a ka përfunduar apo jo, mirëpo nuk e kuptoj se si në këtë projekt shtohen 90.000 € kur dihet se punët shtesë mund të jenë deri në 10%, nëse nuk është rrugë e re, unë këtë e quaj jo profesionalizëm.

Sa i përket ndërtimit të shkollës në fshatin Llapashticë të Poshtme, do të ishte mirë që Komuna të kishte buxhet me e ndërtuar atë shkollë por më mirë është ajo të ndërtohet me buxhet të MASHT – it, ashtu siç është e rregulluar me ligj, mirëpo pavarësisht nga kjo nuk jam në dijeni se a është përgatitur projekti zbatues i punimeve në mënyrë që të dihet kostoja e ndërtimit të atij objekti dhe a do të përfundojnë punimet deri në shtator 2016.

Në Kuvend të Komunës e kemi miratuar Vendimin për themelimin e Teatrit të Qytetit, për këtë subjekti i jonë politik ka kërkuar që të ndahet 10.000 €, por deri më tani për fillimin e punës dhe funksionalizimin e teatrit nuk është destinuar qoftë edhe ndonjë shumë simbolike.

Grupi i këshilltarëve i PDK – së e mbështet rishikimin e buxhetit por që shpërndarja e mjeteve të bëhet pa baza politike.

**z. Kadri Avdiu**, theksoi, sipas materialit vërejtja se disa projekte janë hequr nga prioritetet siç është rasti i projektit për asfaltimin e disa rrugëve në fshatin Bellopojë, pastaj ndërtimi i kanalizimit në drejtim të lagjeve Neziri, Ramadani, Deshishku dhe Rakovica, nuk e kuptoj si ka mund të hiqet ky projekt kur dihet se gjendja është mjaftë e rëndë për shkak të mungesës së kanalizimit, projekt për të cilin na është thënë se në vitin 2016 do të realizohet. Gjithashtu nuk parashihet ndërtimi i kanalizimit të shkollës që është premtuar se do të lidhet me kanalizimin e tre fshatrave.

**z. Haki Rudari**, theksoi, me ligj parashihet rishikimi i buxhetit dhe kjo për ne është e arsyeshme por është kundërshtuese mënyra se si bëhet ridestini i mjeteve, vërejtja ime dhe vërejtja vazhdueshme e Grupit të këshilltarëve të LVV – së është që përmes ridestinit të mjeteve po hapen kode të reja në mjedise prej nga vijnë zyrtarët e lartë të LDK – së. Me këtë rishikim të vitit 2016 janë 5 kode të reja, kuptohet çdo kush jep propozime prej nga vjen apo për mjedise të caktuara, por unë kam dhënë disa propozime të cilat i kam marrë nga takimet që i kam pasë me qytetarë dhe atë për projekte të cilat qytetarët i kanë përgatitur para dy viteve, mirëpo ato propozime nuk janë përfshirë në prioritetet, andaj jam i mendimit se është plotësisht e pa pranueshme që të parashihen kode të reja pa u analizuar kërkesat e mëparshme.

Kemi më shumë se 950.000 € të cilat duhet të ridestinohen e kjo është shumë mjaftë e lartë.

Brenga ime është se kur po kemi të bëjmë me buxhetin po parashihen mjete në kuptimin vetëm të figurojnë e pastaj ato ridestinohen në projekte të tjera, kjo nuk duhet të ndodhë.

Në vazhdimësi kemi përmendur se nga qeverisja lokale mungon një program qeverisës në përgjithësi, ngase si mund ta votojmë ne nesër këtë ridestini në Kuvend kur nga Qendra e hapur për sport dhe rekreacion merren 76.482 € dhe barten për zgjerimin e sallës së teatrit kur dihet se për Qendrën e kulturës në vazhdimësi janë paraparë mjete dhe ato mjete më vonë janë bartë në projekte të tjera.

Në parim e përkrahim ndërtimin e shkollës në fshatin Llapashticë, mirëpo kjo tregon se projektet orientohen në mjediset ku është ndikimi më i madh politik, kjo për ne është shqetësuese dhe plotësisht e papranueshme.

**z. Islam Revuqi**, theksoi, gjatë diskutimit z. Rafet Llapashtica e përmendi projektin në fshatin Bradash, mirëpo në aspektin kadastral ajo pjesë është në kuadër të fshatit Bajçinë, sipas mendimit tim projekti është dashtë të ndahet në dy projekte dhe atë asfaltimi i rrugës Bradash – Lagjja e Revuçëve dhe rruga lagjja e Revuçëve – Lepajë, mirëpo dëshiroj të shtoj edhe këtë se nuk besoj që ndonjë rrugë është në gjendje më të keqe se rruga për të cilën jemi duke diskutuar.

**z. Kumrie Hoti**, theksoi, unë e kam një propozim paksa më ndryshe se herëve të tjera, kam një propozim për një kategori shumë të cënueshme të qytetarëve tanë, në këtë rast e kam fjalën për të gjitha nënat vetushqyese në Komunën e Podujevës dhe pasi jemi në një moment shumë të rëndësishëm në marrjen e vendimit për rishikim të buxhetit, me qëllim të lehtësimit dhe përmirësimit të jetës së qytetarëve të kësaj kategorie dhe duke besuar thellë se do ta mbështesni këtë propozim timin po ju drejtohem me kërkesë për shqyrtim të propozimit për miratimin e vendimit për lirimin e nënave vetushqyese nga pagesa e tarifave për fëmijët e tyre në institucionin për edukimin dhe arsimimin

parashkollor në Podujevë. Pra kërkesa ime ka të bëjë për krijimin e një kodi të ri për kategorinë e përmendur, ndërsa për detaje më të shumta mund të debatojmë në mbledhje të Kuvendit.

**z. Durim Salihu**, drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit, theksoi, z. Rafet Llapashtica kërkoi sqarime për kodin e ri të projektit për asfaltimin e rrugës Orllan – Ballaban është nënshkruar Memorandumi me Ministrinë e Infrastrukturës për periudhën 2016 – 2018 dhe mjetet në shumë 10.000 € janë paraparë për hartimin e projektit.

Për kodin e ri të projektit për asfaltimin e rrugës “ Ragip Hoti “ në fshatin Bradash, edhe pse i përkas subjektit politik LDK lirshëm mund të them se mburrem që ky projekt është propozuar në prioritete mjedis në të cilin shumica e elektoratit është PDK dhe për këtë e përgëzoj z. Agim Veliun, Kryetarin e Komunës. Shuma e këtij projekti është caktuar në bazë të krahasimeve me disa rrugë të gjatësisë së përafërt.

Kodi i ri i projektit për asfaltimin e rrugës në fshatin Dobratin, lagjja Bajgora janë ridestinuuar mjete në shumë 90.000 € dhe kjo ka të bëjë me pjesën e rrugës ku qytetarët për furnizim me ujë të pijes frekuentojnë për Kaqanuell përkatësisht Bajgorë, rrugë e cila është në gjendje mizore.

z. Kadri Avdiu, ka të drejtë për vërejtjet që i bëri për atë që nuk janë përfshirë projekte në fshatin Bellopojë, jemi në dijeni se ka nevojë për investime, mirëpo në vitin 2016 për këtë fshat nuk kemi pasë asnjë kod për ndonjë projekt.

z. Haki Rudari potencoi se mjetet janë duke u ridestinuuar në mjediset prej nga janë zyrtarët e LDK – së, nuk pajtohem me këtë konstatim ngase pak më parë e përmenda rrugën “ Ragip Hoti “ projektin në Orllan pastaj projektin në Gllamnik ku personalisht kam qenë dhe e kam parë se shumica e familjarëve janë me aftësi të kufizuara, kjo është arsyeja përse e kemi propozuar asfaltimin e asaj rruge.

Sa i përket asfaltimit të rrugës në fshatin Bradash që e ngriti z. Islam Revuçi, ne e kemi vlerësuar gjendjen në terren dhe jemi përcaktuar që të mos bëhet projekti për lagje përkatëse por projekti të bëhet si tërësi.

**z. Islam Revuçi**, nuk u pajtua me parafolësin dhe shtoi, kërkesa e jonë ka qenë që të asfaltohet pjesa e rrugës deri te lagjja e Revuçëve dhe duke u bazuar se pjesa tjetër nuk ndërlihet fare me atë lagje jam i mendimit se projektet është dashtë të parashihen ndaras, pra është dashtë të parashihet projekti lagjja e Revuçëve në fshatin Bradash.

**z. Faik Muçiqi**, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit, theksoi, z. Rafet Llapashtica e ngriti çështjen e kanalizimit fekal në fshatin Dyz, për këtë projekt janë paraparë mjete afërsisht për tri kilometra, mirëpo sipas disa paramatjeve për me u kompletuar i gjithë fshati duhen 7 apo 8 km. kanalizime dhe këtë projekt në tërësi mendojmë ta realizojmë brenda dy viteve.

Ndërtimi i kanalizimit në fshatin Bellopojë nuk është heqë por nuk ka qenë i koduar për këtë vit, projekt i cili komplet është në gjatësi afro tre km. pra këtë vit nuk ka mundësi të realizohet.

**z. Isuf Latifi**, theksoi, më parë kur thuhej, renovim dhe zgjerim i shkollave, bëhej vërejtje përse nuk është specifikuar e tani kur në mënyrë të qartë specifikohet, ndërtimi i shkollës në fshatin Llapashticë të Poshtme në shumë 230.963 €, projekt i cili është paraparë për shkak të gjendjes shumë të rëndë të objektit të vjetër. Jemi të vetëdijshëm se ndërtimi i objekteve shkollore është në kompetencë të MASHT –it e cila në prioritete e ka ndërtimin e objektit shkollor në fshatin Bajçinë në vlerë mbi 700.000 €,

por shkolla në Llapashticë të Poshtme nuk është në planifikimet e kësaj ministrie, ne do të ishim shumë të kënaqur që këto mjete t'i destinonjë në ndonjë projekt tjetër por duke u bazuar në nevojën e madhe jemi përcaktuar për realizimin e këtij projekti.

Sa i përket fushave të hapura, unë më parë e përmenda se ky projekt është dyvjeçar që ka filluar në vitin 2015 dhe përfundon në vitin 2016, projekt i cili do të përfundon këtë vit.

**z. Rafet Llapashtica**, theksoi, pyetja ime ka të bëjë me atë që nëse gjithsej 290.000 € kanë qenë për mirëmbajtje të shkollave në tërë Llapin, në 51 shkolla duke përfshirë edhe ato parashkollore, nëse merren mjetet për ndërtimin e objektit shkollor shtrohet pyetja sa mjete i mbeten drejtorisë së Arsimit për mirëmbajtje të shkollave.

Jam në dijeni për gjendjen e shkollës në Llapashticë të Poshtme jam edhe për atë që të ndërtohet por brenga ime është se në shtator me fillimin e vitit të ri shkollor a do të ketë mjete për mirëmbajtjen e objekteve shkollore.

**z. Isuf Latifi**, theksoi, për mirëmbajtje të objekteve shkollore dhe funksionimin normal të procesit mësimor është një kod tjetër i kategorisë së mallrave dhe shërbimeve në shumë 400.000 €.

**z. Haki Rudari**, theksoi, unë isha shumë i qartë se ne nuk jemi kundër ndërtimit të shkollave por unë në vazhdimësi kam kërkuar që projektet të specifikohen në mënyrë të qartë, mirëpo vërejtja ime është se këto investime komplet duke përfshirë edhe investimet në Llapashticë janë të LDK – së.

Ka dy vite e më tepër projekti i lagjes Bekolli në fshatin Shajkoc nuk përfshihet në prioritetet e arsyeja është se janë në Vetëvendosje dhe ka shumë lagje të tjera në të cilat nuk parashihen investime vetëm për atë se nuk janë në LDK.

**z. Fidan Rekalju**, theksoi, ne të gjithë duhet t'i gëzohemi çdo zhvillimi i cili ndodh në Komunën e Podujevës, gjithashtu investimeve nga qeverisja lokale duhet t'u gëzohemi të gjithë. Dihet çdo kund nga pak ka lëshime por të paqëllimta, unë i përgëzoj drejtorët për punët dhe angazhimet e bëra mirëpo duhet ta kemi të gjithë të qartë se LDK – ja është subjekti i cili me program ka fituar në Komunën e Podujevës, andaj LDK – ja qeverisë me program dhe do t'i fitoj zgjedhjet në vazhdimësi.

Pas votimit u konstatua se Rishikimi i buxhetit për vitin 2016, Kuvendit i rekomandohet për shqyrtim me 9 vota për, asnjë kundër dhe asnjë votë të përmbajtur.

**Mbledhja përfundoi në orën 16.05'.**

**Procesverbalin e mbajti  
Faik Gashi**

**Nr. 01-006-43644  
Podujevë,  
24 maj 2016**

**Kryesuesi i Komitetit  
Mehmet Gashi**